



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 376/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Muharrem Shala Kryesues, Ymer Hoxha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Blerim Graincës kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Alban Baliu komisioner nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 19.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e Blerim Graincës kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 18.06.2014, nga Blerim Grainca kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ku pretendon se në qendrën e votimit 2503D konkretisht në vendvotimin 05D përkundër që i ka votat në kutinë e votimit, gjatë plotësimit të formularit komisioneri ka gabuar dhe nuk i ka shënuar fare votat në formularin e raportimit.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi deklaratën e komisionarit të LDK-së Alban Daliu.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 376/2014 më datën 19.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.